



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 438/1 Prot

Tiranë, më 11.02.2025

V E N D I M

Nr. 5, datë 11.02.2025

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE QË PËRFITOJNË BURSË FINANCIARE DHE QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA E SHKOLLIMIT ME 100% NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, PËR VITIN AKADEMIK 2024– 2025, (raste të veçanta, faza e dytë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, ndryshuar me VKM nr.784, datë 26.12.2018 dhe VKM nr. 39, datë 23.01.2019, si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 438 Prot., datë 30.01.2025 në mbledhjen e tij të datës 11.02.2025,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve që përfitojnë bursë financiare dhe që përjashtohen nga tarifa e shkollimit me 100 % në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, për vitin akademik 2024-2025.

2. Efektet financiare për 12 (dymbëdhjetë) studentë që përfitojnë bursë dhe 9 (nëntë) që përjashtohen 100% nga tarifa e studimit janë në total 1,190,000 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, përkatësisht:

a.) Bursat, në vlerën 920,000 (nëntëqind e njëzetë) lekë.

b.) Përjashtimi 100% nga tarifa e studimit në vlerën 270,000 (dyqind e shtëdhjetë) lekë.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI ADMINISTRIMIT

Arta DOLLANI Kryetar

Albert KOPALI Anëtar

Blerina DUKA Anëtar

Altin PRENGA Anëtar

Donika KËRÇINI Anëtar

Sokol DURO Anëtar

Florian NURÇE Anëtar

Konceptoi: N. Ndoci